



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## Study program **Përkthim dhe Interpretim (2019/2020)**

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Titulli	Magjistër në përkthim dhe interpretim
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-24/2
Vendimi për fillim me punë	03-24/4 (31.05.2019)
Data akreditimit	22.04.2019

## Përshkrimi i programit

Parashikohet se në 5-10 vitet e ardhshme, Republika e Maqedonisë së Veriut sigurisht do të arrijë të bëhet anëtare e BE-së. Procesi i bashkimit dhe zhvillimit që do të rezultojë me pranim. Periudha më pas do ta rrisë në mënyrë të konsiderueshme nevojën për shërbime përkthimi dhe interpretimi në gjuhët maqedonase / shqip në gjuhët e BE-së (duke përfshirë anglishten/frëngjishten/gjermanishten). Ndërkohë, ndërmarrjet e biznesit dhe sektori turistik do të vazhdojnë të kenë nevojë për përkthyes dhe interpretues kompetentë, pastaj për dokumente dhe për mbledhje e konferenca; si rrjedhim i kësaj ka një nevojë tash dhe do të ketë edhe në të ardhmen në treg për përkthyes dhe interpretues të pavarur apo brenda institucioneve.

Fokusi kryesor i këtij programi pasdiplomik për *përkthim dhe interpretim* do të jetë për të hapur mundësi për përkthim për individët gjuha amtare e të cilëve është gjuha shqipe. Studentët e suksesshëm do të jenë në gjendje të përkthejnë në dhe prej shqipes/ maqedonishtes në anglisht si edhe në gjuhët frënge/gjermane. Si pasojë, programi i përmbush kërkesat e BE-së për kompetencë në të paktën dy gjuhët kryesore të BE-së: anglisht dhe frëngjisht/gjermanisht. Programi gjithashtu lidhet me misionin e Universitetit të EJK-së për forcimin e mundësive arsimore të komunitetit shqiptar në RMV. Njëherësh kështu sigurohet një mjedis mësimi Evropian, shumëgjuhësor dhe ndërkulturor.

## Karriera

Elementet kryesore për mundësinë e punësimit të të diplomuarve në treg nga programi pasdiplomik *përkthim dhe interpretim* janë si më posht:

- Studentët do të kenë kompetencë në gjuhën e tyre amtare plus dy gjuhë evropiane (anglisht dhe frëngjisht/gjermanisht). Kjo e përmbush kërkesën e BE-së për përkthyesit për të treguar kompetencë në më së paku dy gjuhë kryesore të BE-së.
- Studentët do të mësojnë për çështjet politike dhe ekonomike në lidhje me funksionimin e BE-së gjatë studimeve të tyre në këto kurse: Përkthim për BE-në dhe organizatat ndërkombëtare, institucionet e BE-së dhe për fushat e buxhetimit dhe integritimit në BE dhe zgjerimi të këtij unioni.
- Studentët do të marrin trajnim në përkthim për qëllime specifike duke përfshirë përkthime juridike, afariste dhe teknike.
- Studentët do të jenë të detyruar të ndjekin praktikë në vende pune/stazh si pjesë e studimeve të tyre dhe kjo do të monitorohet dhe do të vlerësohet si pjesë e programit.

- Programi u dedikohet studentëve gjuha amtare e të cilëve është gjuha shqipe apo gjuha maqedonase dhe për këtë arsye ai ofron mundësi për të dy gjuhët e komuniteteve brenda RMV.

## Rezultatet e të mësuarit

### Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka zotërim të plotë të më së paku dy gjuhëve: një gjuhë të Ballkanit (shqip/maqedonisht) dhe një gjuhë evropiane (anglisht/gjermanisht/frëngjisht);
- Ka kuptim të thellë të çështjeve teorike në lidhje me fushën e përkthimit;
- I njeh teknikat dhe metodat e përkthimit;
- I ka zotëruar çështjet gramatikore dhe gjuhësore të ngritura gjatë projekteve dhe detyrave të përkthimit;

### Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Tregon kompetencë në përkthim konsektiv dhe simultan;
- Është në gjendje të gjejë ekuivalencë të përshtatshme për terme të vështira dhe formulime të pazakonta;
- Mund të përdorë mjetet e përkthimit me ndihmën e kompjuterit;
- Mund të përshtatet në kushtet e interpretimit për organizata të mëdha;

### Aftësitë për të vlerësuar

- Është në gjendje të bëjë gjykime të dalluara të zgjedhjes së fjalëve dhe strukturës së fjalisë gjatë bërjes së detyrave të përkthimit dhe interpretimit;
- Bën gjykime lidhur me vështirësinë e mundshme të aspekteve të ndryshme të gjuhës në objektivat: ndërtimi i foljes dhe kohës, nyjat e shquara dhe të pashquara, parafjalët, kategoritë tjera gramatikore, shprehjet idiomatike, renditjet leksikore dhe formimi i fjalëve;
- Aftësi për të identifikuar dhe përcaktuar një lëmi të studimit për përkthim për hulumtimin pasdiplomik;
- Tregon ndjeshmëri për çështjet kulturore që mund të lindin në detyrat e përkthimit dhe interpretimit;

### Aftësitë e komunikimit

- Ka shqiptim të shkëlqyer të gjuhës në objektivat;
- Mund të formulojë fjali dhe fraza në mënyrë të qartë dhe të rrjedhshme nga një gjuhë në tjetër;
- Mund të shkruajë në mënyrë të qartë dhe të saktë gjatë përkthimit të teksteve të shkruara;
- Kupton çështjet e tingëllimit gjuhësor dhe stilit në lidhje me detyrat e interpretimit;

### Aftësitë e të mësuarit

- Është në gjendje t'i vetëmonitrojë dhe t'i përshtatë metodat e përkthimit në përputhje me detyrat e veçanta që i ka;
- Inicion dhe përfundon punë të pavarur hulumtuese të një standardi të lartë akademik brenda një periudhe të caktuar kohore;
- Është i/e aftë për të përdorur aftësitë e hulumtimit për të marrë të dhënat e nevojshme të sfondit lidhur me detyrat e veçanta të përkthimit të natyrës teknike, akademike apo letrare.
- Mund të përshtatë dhe të përdorë mjete përkthimi të ndihmuara nga kompjuteri që janë në zhvillim;

## Lista e lëndëve

### Semestri 1

- [MTI-101] [6.0 SETK] **Linguistika për Përkthyes (Gjuhë Angleze)**
- [MTI-102] [6.0 SETK] **Metoda dhe Qasje të Studimeve për Përkthim**
- [MTI-103] [6.0 SETK] **Përkthim për Qëllime Specifike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### Semestri 2

- [MTI-201] [6.0 SETK] **Linguistika për Përkthyes (Gjuhë Shqipe/Maqedonase)**

- [MTI-202] [6.0 SETK] **Interpretimi Simultan/Konsektiv**
- [MTI-203] [6.0 SETK] **Analiza Kontrastive**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### Semestri 3

- [MTI-301] [6.0 SETK] **Metodat e Hulumtimit në Studimet për Përkthim**
- [MTI-302] [6.0 SETK] **Përkthimi për Bashkimin Evropian dhe Organizatat Ndërkombëtare**
- [MTI-303] [6.0 SETK] **Teknologjitë për Përkthim**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### Semestri 4

- [MTI-400] [30.0 SETK] **Punimi i Magjistraturës**

## Description of courses

### Lëndë obligative

- **Linguistika për Përkthyes (Gjuhë Angleze)**

Qëllimi i linguistikës për përkthyes (gjuhë angleze) është t'u mundësojë studentëve ta përmirësojnë kompetencën gjuhësore në gjuhën angleze dhe t'i rifreskojnë, t'i përforcojnë dhe t'i rishikojnë konceptet teorike gjuhësore si të zbatueshme në disiplinën e përkthimit. Ajo është e dizajnuar në veçanti për studentët për të cilët gjuha angleze është një gjuhë e dytë apo e tretë. Kjo lëndë do t'u japë një kuptim të thellë për strukturat gjuhësore të gjuhës në objektiv nga perspektiva e përkthyesit. Kjo lëndë po ashtu ka për qëllim ta studiojë një gjuhë dhe t'i krahasojë aftësitë e transferueshme të ndryshme gjuhësore nga gjuha burim në gjuhën në objektiv. Kjo lëndë do të rishikojë dhe do të fusë koncepte nga linguistika e aplikuar. Këto koncepte do të jenë të dobishme për përkthyesit në praktikën e tyre profesionale. Fushat e mbuluara përfshijnë morfologjinë, sintaksën, leksikologjinë, fushat semantike, kombinime fjalësh, kohezionin dhe analizën kontekstuale. Gjatë gjithë orëve do të jepen shembuj se si të kuptuarit e strukturës së gjuhës angleze informon procesin e përkthimit.

- **Metoda dhe Qasje të Studimeve për Përkthim**

Qëllimi i këtij moduli është që të shërbejë si hyrje në çështjet teorike në lidhje me përkthimin. Fushat në vazhdim do të mbulohen me lëndët: llojet e përkthimeve, kufizimet e ekuivalencës ndërgjuhësore, probleme të përgjithshme të përkthimit, vlerësimi i përkthimit. Gjithashtu do të merren parasysh qasjet specifike të përkthimit në përgjithësi, tekstet letrare dhe temat e veçanta. Në lidhje me këtë, do të studiohet një numër i konsiderueshëm i llojeve të ndryshme të teksteve në gjuhën angleze me një synim që të lehtësohet prodhimi i përkthimit të rrjedhshëm në zhanre të ndryshme. Lënda metoda dhe qasje të studimeve për përkthim do ta kombinojë teorinë dhe praktikën për t'iu qasur përkthimit me tërë ndërlidhimin e saj, si një art edhe si një shkencë. Në lexim, diskutim dhe praktikë, si dhe prezantime do t'i tërheqim perspektivat teorike me qëllim që të ndriçojmë dhe ta lehtësojmë praktikën e përkthimit. Lënda do të përfshijë vlerësimin krahasues të veprave të përkthyer në mënyrë që t'u japë studentëve një depërtim se si metodat e përkthimit mund t'i përmirësojnë dokumentet e përkthyer.

- **Përkthim për Qëllime Specifike**

Kjo lëndë trajton çështje të lidhura me përkthimin dhe interpretimin brenda një fushe të caktuar profesionale. Në fakt bëhet fjalë për përkthimin ekuivalent të lëndës të njohur mirë - anglishtja për qëllime specifike (AQS). Lënda ka për qëllim ta kombinojë teorinë dhe praktikën për t'iu qasur përkthimit nga pikëpamja e konteksteve profesionale të 'botës reale' ku terminologjia teknike dhe e specializuar ka nevojë të shndërrohet nga një gjuhë në një tjetër. Ajo ka për qëllim të shërbejë si një lëndë hyrëse në lidhje me çështjet dhe strategjitë e mundshme të përkthimit që duhet të përvetësohen gjatë përkthimit të teksteve të specializuara. Lënda do të prezantojë disa nga fjalët e specializuara të ligjit dhe rregullores, biznesit dhe financave, teknologjisë industriale dhe TI me qëllim të rritjes së burimeve terminologjike të studentëve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet terminologjisë juridike nga anglishtja në gjuhën në objektiv dhe anasjelltas. Lënda do të vazhdojë përmes diskutimit teorik të konteksteve të ndryshme të përkthimit dhe të mjediseve sociale pranë përkthimit praktik të teksteve autentike të cilat do të shërbejnë për të ilustruar çështjet e përfshira. Një sesion tipik i orës do të përfshijë prezantimin dhe diskutimin e leximeve nga tekstet e kërkuara. Po ashtu këtu do të ketë edhe ushtrime të fokusuar dhe redaktim të kolegëve me krahasim dhe analiza të teksteve dhe dokumenteve të përkthyer.

- **Linguistika për Përkthyes (Gjuhë Shqipe/Maqedonase)**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i studiojë modelet e zërit, formimin e fjalëve, strukturën e fjalive, kuptimin dhe përdorimin e gjuhës në gjuhën amtare të studentëve. Po ashtu ka për qëllim të sqarojë si funksionon gjuha, si ndërveprojnë gjuhët, si mësohet gjuha dhe si ndryshojnë gjuhët. Kjo lëndë do t'u ndihmojë studentëve ta kuptojnë se si modelet leksikore dhe gramatikore janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen dhe stilin; si i transmetojnë qëndrimet dhe mendimet e tyre shkrimtarët dhe folësit; dhe si ndikojnë faktorët kontekstualë në prodhimin dhe perceptimin e përkthimit dhe interpretimit. Kjo lëndë i zhvillon aftësitë gjuhësore të studentëve në gjuhën e tyre amtare, gjuhë shqipe apo maqedonase. Ajo do t'i përsërisë dhe do t'i fusë konceptet nga linguistika e aplikuar të cilën përkthyesit do ta gjejnë të dobishme në praktikën e tyre profesionale. Gjatë modulit do të jepen shembuj se si një e kuptuar e mënyrës në të cilën gjuhët funksionojnë informon procesin e përkthimit me një theks të veçantë në tiparet gjuhësore të gjuhës shqipe/ maqedonase.

- **Interpretimi Simultan/Konsekutiv**

Kjo lëndë ka për qëllim t'u mundësojë studentëve të interpretojnë në mënyrë konsektive dhe simultane nga shqipja/maqedonishtja në anglisht dhe anasjelltas. Lënda, gjithashtu, ka për qëllim të prodhojë përkthime kompetente të fjalimeve, diskutimeve publike, ligjëratave të kohëzgjatjeve të ndryshme dhe që kanë lidhje me tema të ndryshme. Studentët do të mësojnë aftësitë e marrjes së shënimeve dhe ndihma të tjera të kujtesës për interpretim efektiv konsektiv dhe ata do të tregojnë aftësitë e zhvilluara të mbajturit mend dhe aftësitë analitike kur merren me detyrat e zgjeruara të interpretimit. Kjo lëndë i njofton studentët me metodat e interpretimit edhe në mënyrën konsektive edhe në mënyrën simultane. Ajo do t'i zhvillojë shkathtësitë e të dëgjuarit, shkathtësitë e kujtimit, shkathtësitë e të marrit shënime dhe shkathtësitë analitike dhe do të sigurojë praktikë për interpretim në një mjedis të simuluar të interpretimit në konferencë/seminar. Theksi do të bjerë mbi praktikën e interpretimit në një mjedis autentik të interpretimit me shpejtësi dhe saktësi të përkthimit që është duke u vlerësuar dhe analizuar.

- **Analiza Kontrastive**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptet dhe parimet e analizës kontrastive dhe analizën e gabimeve- edhe teorike edhe të zbatuara. Lënda është dizajnuar për të rritur vetëdijësimin e studentëve për dallimet në mes gjuhëve, posaçërisht shqip/maqedonisht dhe anglisht. Temat do të përfshijnë një përmbledhje dhe një hyrje në çështjet terminologjike dhe hulumtuese; bazën psikologjike të analizës kontrastive; teorinë gjuhësore dhe analizën kontrastive; burimet e gabimeve; përshkrimin dhe nivelet e gabimeve; gabimet dhe strategjitë e të mësuarit të një gjuhe të dytë; dhe analizën kontrastive e gabimet dhe mësimdhënien e gjuhës. Kjo lëndë do ta studiojë analizën kontrastive si një qasje e përgjithshme për hetimin e gjuhës, veçanërisht si një çështje e drejtuar në fushat e caktuara të gjuhësisë së aplikuar si: mësimdhënia e gjuhës së huaj dhe përkthimi, ku janë identifikuar pikat e diferencës strukturore midis dy gjuhëve të huaja dhe pastaj këto studiohen si fusha të vështirësisë së mundshme në nxënien e gjuhëve të huaja dhe përkthimit. Lënda do të mbajë një eksplorim të thellë të analizës kontrastive dhe do të vlerësojë rolin e saj në gjuhësinë teorike dhe të aplikuar dhe si një mjet për përkthyesit në praktikën e tyre të punës. Ajo jep një kuptim të thellë se si sillen tiparet gjuhësore në kryqëzimet gjuhësore me një theks të veçantë në palët e gjuhëve shqipe/maqedonase dhe angleze.

- **Metodat e Hulumtimit në Studimet për Përkthim**

Kjo lëndë ka për qëllim që të trajtojë dhe përgatisë studentët për hulumtime të avancuara në studimet e përkthimit, në mënyrë specifike për tezën e tyre të magjistraturës, e cila është pika e kompletimit të programit pasdiplomik në përkthim dhe Interpretim. Ky modul ka për qëllim t'i përgatisë studentët të hulumtojnë dhe të shkruajnë një disertacion të magjistraturës apo koment (trajtesë) projekti në studimet e përkthimit/interpretimit. Ata do të mësojnë si të përdorin një sërë metodash të hulumtimit dhe mjeteve të kërkimit në bibliotekë. Studentët po ashtu do të mësojnë për karakteristikat specifike kapitull pas kapitullit të disertacioneve. Kjo lëndë do t'i pajisë studentët me shkathtësitë e nevojshme të hulumtojnë dhe të shkruajnë një tezë magjistrature në përkthim. Ajo do të mbajë mësim mbështetës në përgatitjen dhe shkrimin e tezës së magjistraturës. Ajo, gjithashtu, do t'i sugjerojë sferat e fushës të studimeve të përkthimit, ku hulumtimi i tanishëm është duke u ndërmarrë. Kjo do të lejojë hapësirë edhe për një hyrje në analizën krahasuese të përkthimit përmes vlerësimit krahasues të përkthimeve klasike dhe komentit që ka evoluar në këto si një rrugë e mundshme e kërkimit të të dhënave për tezën e magjistraturës

- **Përkthimi për Bashkimin Evropian dhe Organizatat Ndërkombëtare**

Kjo lëndë ka për qëllim t'u mundësojë studentëve një ide të shëndetshme të politikës gjuhësore të organizatave më të mëdha ndërkombëtare siç janë BE ose KB. Ajo do t'i pajisë studentët me njohuritë themelore të historisë, me karakterin politik dhe funksionimin e organizatave më të mëdha dhe do të bëjë një vlerësim të normave të tyre procedurale. Një prej fokuseve të lëndës do të jetë protokollit i përkthimit dhe si duhet t'u përshtaten përkthyesit standardeve dhe praktikave institucionale. Një qëllim sekondar i lëndës do të jetë të ekzaminojë kompleksitetin e

përkthimit të teksteve legislative nëpërmjet të mësuarit të terminologjisë specifike të përdorur në organizatat ndërkombëtare. Ajo po ashtu do t'i ndihmojë studentët që dëshirojnë të kryejnë hulumtime në fushën e përkthimit për organizatat ndërkombëtare. Kjo lëndë do të ekzaminojë si funksionojnë organizatat më kryesore ndërkombëtare në aspektin e nevojave të tyre të përkthimit. Ajo do të ekzaminojë punën e Drejtorisë së përgjithshme për përkthim e cila i shërben Bashkimit Evropian për nevojat e përkthimeve. Ajo, gjithashtu, do ta ekzaminojë punën e organeve ekuivalente brenda organizatave të mëdha ndërkombëtare si: Kombet e Bashkuara, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe UNESCO. Ajo do ta ekzaminojë historinë dhe arsyet e themelimit të organizatave të tilla për të shpjeguar specifikat e përkthimit për ta. Më tej, ajo do ta ekzaminojë gjuhën specifike të ligjit dhe legjislacionit të përdorura nga ana e këtyre organeve dhe ajo do ta eksplorojë klasifikimin e organizatave ndërkombëtare si dhe rolin dhe funksionin e tyre në politikën globale.

#### • **Teknologjitë për Përkthim**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i mundësojë studentët të përdorin një sërë të mjeteve komerciale (CAT- Përkthim me ndihmën e kompjuterit) gjatë bërjes së detyrave praktike për menaxhim të terminologjisë, përkthim të dokumentacionit, lokalizim të programit dhe menaxhim të projektit si dhe për të eksportuar dhe për të importuar përkthime dhe terminologji midis aplikacioneve të ndryshme. Kjo lëndë, gjithashtu, ka për qëllim t'u mundësojë studentëve të marrin pjesë e të koordinojnë projekte shumëgjuhësore të përkthimit dhe të projektojnë e të këshillojnë për metodat e përshtatshme të prodhimit për faqet e ndërkombëtarizuara të internetit. Duke i angazhuar studentët me një shumëllojshmëri të mjeteve të përkthimit me ndihmën e kompjuterit, ky modul i lejon ata të zhvillojnë jo vetëm ekspertizë praktike, por edhe një fushë shkencore për vlerësimin e meritave të tyre përkatëse. Për të simuluar mjedisin profesional, moduli në masë të madhe është i organizuar rreth projekteve ekipore që mbulojnë një gamë të gjuhëve që paraqesin sfida të ndryshme gjuhësore dhe teknike, duke përfshirë gjuhët që janë në objektiv në rajon, si maqedonishtja, shqipja, anglishtja dhe gjermanishtja. Vlerësimi i modulit fokusohet në vlerësimin kritik të dobisë dhe përdorshmërisë së mjeteve dhe aftësisë për të punuar në mënyrë efektive në një ekip shumëgjuhësor të përkthimit.

#### • **Punimi i Magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, punimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Kolegjiumi arsimor i studimeve pasdiplomike dhe nga Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit. Pas përgatitjes së versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli mësimor-shkencor formon komisionin prej tre anëtarësh, që e përgatit raportin, i cili mund të pranohet ose të refuzohet. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli mësimor-shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike. Pas mbrojtjes me sukses të tezës, studenti merr titullin – Magjistër në përkthim dhe interpretim.

### **Lëndë zgjedhore**

#### • **Gjuhë Gjermane 1**

Kjo lëndë përmban një zgjerim të kompetencave themelore komunikative në fushat e të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit në mjedise më të ndërlikuara bisedore dhe lloje të teksteve. Pjesëmarrësit mësojnë të shprehin synimet, të paraqesin argumentet, të gjeneralizojnë dhe të bëjnë krahasime me qëllim që të zotërojnë mjediset më zyrtare linguistike si, ndjekje të studimeve, diskutime dhe prezantime. Studentët janë të inkurajuar të përgatisin dhe të përkthejnë në dhe prej teksteve më të ndërlikuara si një pjesë e përgjithshme e forcimit të kompetencave të gjuhës. Përveç kësaj, në kuadër të lëndës do të ketë lloje të ndryshme të teksteve të përkthyer nga gazetaret dhe revistat gjermane në gjuhën shqipe dhe maqedonase dhe anasjelltas. Tekstet e përkthyer do të zgjidhen nga vetë studentët si dhe tekstet e rëndësishme që kanë të bëjnë me studentët dhe problemet e universiteteve. Tekstet e përkthyer nga gjermanishtja në gjuhën shqipe dhe maqedonase do të analizohen. Në sajë të këtyre ushtrimeve studentët, po ashtu, do të zgjerojnë fjalorin e tyre të gjuhës gjermane. Kompetenca e gjuhës së studentëve sipas Kornizës së përbashkët evropiane të referencës (CEFR) do të jetë në nivelet B1.1 dhe B1.2.

#### • **Gjuhë Gjermane 2**

Kjo lëndë fillon me një konsolidim të aftësive dhe të njohurisë së mëparshme të nivelit ndërmjetësues dhe pastaj vazhdon në strukturat gramatikore që kërkojnë më shumë, siç janë lidhoret, lloje të ndryshme të lidhjeve të fjalisë dhe lidhëzat përkatëse. Aftësitë stilistike të studentëve do të zgjerohen me anë të hartimit të teksteve të ndryshme përmes së cilës e njohin nga afër vetveten me lloje dhe struktura të ndryshme tekstuale. Pjesëmarrësit do t'i përmirësojnë aftësitë e tyre retorike duke bërë prezantime gojore. Për të zgjeruar të kuptuarit e leximit, do të përdoren tekste që kërkojnë informata socio-kulturore dhe pjesë themelore letrare. Përveç kësaj, në kuadër të lëndës do të ketë lloje të ndryshme të teksteve të përkthyer nga gjermanishtja në gjuhën shqipe dhe maqedonase dhe anasjelltas. Këto tekste do të jenë autentike dhe do të përfshijnë: shkrime gazetareske, dokumente zyrtare juridike

dhe afariste, tekste teknike dhe shkencore si edhe disa shkrime kreative dhe letrare. Moduli ka për qëllim t'i forcojë aftësitë gjuhësore për të arritur zotësi më të madhe në detyrat e përkthimit. Kompetenca e gjuhës së studentëve sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës (CEFR) do të jetë në nivelet B1.2 dhe B2.1

### • Gjuhë Gjermane 3

Kjo lëndë përfshin një zgjerim të aftësive gjuhësore në një nivel të lartë nëpërmjet të teksteve gazetareske, letrare dhe akademike. Ajo përdor teknika të të nxëniet përmes të cilave studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të punojnë me më shumë lloje të teksteve të ndërlikuara. Pjesëmarrësit do të fitojnë afërsi me bazat e të shkruarit akademik dhe të punojnë në përmirësimin e aftësive të tyre shprehëse stilistike. Strategjitë që janë mësuar në këtë mënyrë do t'u mundësojnë studentëve të shprehin vetveten në lidhje me aspekte të ndryshme të jetës politike, kulturore dhe sociale në diskutimet dhe prezantimet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe koherente. Në nivelin e avancuar, fletoret e ushtrimeve përdoren si materiale bazë me qëllim të konsolidimit të aftësive gramatikore. Përtej kësaj, studentët dhe mësimdhënësit e tyre kryesisht punojnë me materiale të teksteve autentike. Përveç kësaj, lënda do t'i njoftojë studentët me aspektet e avancuara stilistike të avancimit, kryesisht nga gjermanishtja në gjuhën amtare të studentëve. Në këtë fazë pritet që studentët të tregojnë një nivel të lartë të aftësive në gjetjen e fjalës dhe ekuivalencës strukturore në tekstet e shkruara dhe po ashtu të tregojnë kompetencë në interpretimin e gjermanishtes së folur. Kompetenca gjuhësore e studentëve sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës (CEFR) do të jetë në nivelet B2.2 dhe C1.1. Temat: Punë dhe studime: organizimi dhe komunikimi - koha dhe harxhimi i kohës: hobit, librat dhe sportet - ngjarje dhe lajme, TV dhe krim tregimet - teknologji, shpikjet dhe tendencat - mjedisi dhe shëndeti, të ushqyerit dhe sporti, zhurma dhe sporti - komunikimi: biseda të vogla, deklaratat, komunikimi joverbal - ndjenjat pozitive dhe negative. Strukturat: lidhoret II (të gjitha kohët, me foljet modale, format origjinale të disa foljeve të forta)- foljet me rasën kallëzore, dhanore dhe parafjalët - transformimi i shprehjeve parafjalore në fjali vartëse dhe anasjelltas - të folurit e zhdrejtë: përdorimi i foljes "sollen" dhe lidhoret I - lidhjet emër - folje - pësori dhe zëvendësuesit e pësorit - krahasimi i dyfishtë dhe pjesoret e zgjeruara - fjalitë e bashkuara.

### • Institucionet e Bashkimit Evropian dhe Buxhetimi

Lënda synon t'i njohë studentët me nocionin themelor të funksionimit të institucioneve të BE-së, teoritë e integritetit të BE-së, me praktikën e institucioneve të BE-së dhe proceset vendimmarrëse të BE-së me përqendrim të veçantë në politikën fiskale dhe buxhetimin e shteteve anëtare të BE-së. Lënda, po ashtu do ta theksojë rëndësinë e krijimit të kornizës buxhetore afatgjate që themelon shpërndarje legjitime dhe efikase të mallrave dhe shërbimeve publike. Lënda do të përqendrohet në strukturën e buxhetit të shteteve anëtare të BE-së dhe në veçanti do t'i analizojë politikën e qeverisë qendrore dhe shpërndarjen e burimeve midis niveleve të ndryshme financiare të qeverisë në kuadër të Bashkimit. Veç kësaj, brenda kornizës së lartpërmendur programi i lëndës do të marrë parasysh statusin e reformave të politikës fiskale të Republikës së Maqedonisë. Duke marrë parasysh kalendarin e tashëm akademik të mësimdhënies/nxënies lënda është paraparë të realizohet prej 12 deri në 14 javë, dhe do të përfshijë temat e mëposhtme: -Institucionet e Bashkimit Evropian dhe paraardhësit e tij; -BE-ja si një arenë e veçantë për lëvizje dhe zhvillim (ose ndoshta jo); - Teoritë e integritetit evropian; - Krijimi i politikave për zhvillim të BE-së; - Çështjet e globalizimit, evropianizimit dhe legjitimiteti demokratik; - Politika e tregut të vetëm dhe procesi i zgjerimit të BE-së; - Politika fiskale e BE-së; - Ndikimi i politikës fiskale në shtetet anëtare të BE-së; - Ndikimi i politikës fiskale në procesin e zgjerimit të BE-së; - Harmonizimi i politikës institucionale dhe fiskale të Maqedonisë (rruga për anëtarësim për në BE); - Statusi i Maqedonisë dhe sfidat e politikës fiskale në rrugën e Maqedonisë për anëtarësim në BE.

### • Përkthimi Juridik, Afarist dhe Teknik

Pritet që studentët të përmirësojnë të kuptuarit e tyre të parimeve themelore të analizimit të teksteve dhe disa teorive të njohura në lidhje me përkthimin e teksteve të veçanta nga fusha e juridikut, afarizmit dhe shkencës. Ata po ashtu pritet të identifikojnë dhe përcaktojnë strategjitë më të mira të përkthimit për qëllime specifike profesionale. Nëpërmjet punës praktike në llojet e ndryshme të teksteve ata pritet të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e tyre teorike të teorisë së përkthimit dhe praktikën për të përmirësuar aftësitë e tyre analitike dhe të kuptuarit e të gjithë faktorëve që ndikojnë në përkthimin e teksteve të veçanta. Pritet që studentët ta përmirësojnë të kuptuarit e tyre të parimeve themelore të analizimit të teksteve dhe disa teorive të njohura në lidhje me përkthimin e teksteve të veçanta nga fusha e juridikut, afarizmit dhe shkencës. Ata po ashtu pritet t'i identifikojnë dhe t'i përcaktojnë strategjitë më të mira të përkthimit për qëllime specifike profesionale. Nëpërmjet punës praktike në llojet e ndryshme të teksteve ata pritet të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e tyre teorike e praktike të përkthimit dhe t'i përmirësojnë aftësitë e tyre analitike dhe të kuptuarit e të gjithë faktorëve që ndikojnë në përkthimin e teksteve të veçanta. Lënda do të përqendrohet në një numër të projekteve për analizën e teksteve përmes të cilave studentët do të njihen me çështjet themelore konceptuale dhe praktike në përkthimin e teksteve nga fusha e juridikut, biznesit dhe shkencës. Lënda do t'i ndihmojë studentët t'i identifikojnë llojet e ndryshme të teksteve burimore, t'i ndërtojnë aftësitë e tyre për analizë të tekstit dhe do t'u ndihmojë atyre t'i zgjedhin strategjitë e sakta kur përkthejnë tekste të ndryshme nga fushat e lartpërmendura. Nëpërmjet ushtrimeve të bazuara në projekte, studentët do të pajisen me mundësitë për të përmirësuar aftësitë e tyre analitike dhe të kuptuarit e të gjithë faktorëve që ndikojnë në përkthimin e teksteve

burimore nga fushat specifike në gjuhën në objektiv.

- **Integrimit në Bashkimin Evropian dhe zgjerimi**

Qëllimet e programit të lëndës: - Të mësojnë dhe kuptojnë teoritë e ndryshme ligjore të Bashkimit Evropian duke analizuar teoritë kryesore të ligjit Evropian; - Aftësia për të analizuar rëndësinë dhe zbatimin e teorive për Bashkimin Evropian në praktikë si edhe në implementimin e politikave të BE-së përmes legjislativës së BE-së, domethënë përmes burimeve zyrtare, ligjore dhe pozitive të ligjit të BE-së; - Njohja dhe të kuptuarit e roleve të 28 shteteve anëtare në vendimmarrje në institucionet qeveritare të BE-së dhe të institucioneve të më shumë se një shteti/komuniteti të BE-së si një burim material i ligjit të BE-së; - Rishikimi historik i zhvillimit të ligjit në BE nga idetë fillore rreth integrimit evropian deri te marrëveshjet bazë (ECSC, EEC dhe Evroatom, marrëveshjet e BE-së nga Mاستrihti, Amsterdami, Nicës dhe Lisbonës) dhe analiza e tyre nëpërmjet punës së përditshme të BE-së;

- **Komunikimi Ndërkulturor**

Kjo është një lëndë ndërdisiplinore e cila mbështetet në fushën e zhvillimit akademik të komunikimit ndërkulturor në mënyrë që t'i pajisë përkthyesit dhe interpretuesit me konceptet të cilat do t'u ndihmojnë atyre të negociojnë si në aspektin kulturor ashtu edhe në 'të qenit i huaj' dhe në 'dallimin' gjuhësor. Lënda bazohet në kuptimet e thella të antropologjisë, sociologjisë, studimeve të medias, teorisë kritike dhe kulturore dhe studime të kulturës. Ajo ka për qëllim të eksplorojë koncepte të tilla si: kokë turku (personi që merr fajin përsipër). Tjetri, i stërmunduari, stereotipe racore, kombëtare dhe nacionaliste me një qëllim të nxitjes të një qasjeje tolerante dhe të hapur në praktikën e përkthimit. Ajo më tej ka për qëllim të rrisë vlerësimin e studentëve për nuancën kulturore dhe hollësitë kulturore në punën e tyre të përkthimit. Në këtë lëndë studentët do të njihen me konceptet kryesore, çështjet dhe polemikat lidhur me multikulturalizmin pasi këto ndikojnë në punën e përkthyesve dhe interpretuesve. Ata do të mësojnë se si të kuptojnë dhe të negociojnë nuancën kulturore në gjuhën në objektiv pasi kjo vlen për tabutë kulturore dhe ndalimet. Ata do të mësojnë si të gjejnë ekuivalentet kulturore për fjalët dhe konceptet të cilat nuk mund të transmetohen lehtë në gjuhën në objektiv (për shembull, shprehje që përdorin terminologji të kriketit). Për të lehtësuar këto aftësi të veçanta, studentët do të njihen me aftësitë e dallimeve kulturore nga perspektiva e diturisë në arsimimin multikulturor dhe bashkëpunimin ndërkulturor. Kjo do t'u mundësojë studentëve të tregojnë fleksibilitet dhe respekt për të punuar në fushën e interpretimit dhe të parashikojnë tema, fjalë dhe koncepte të ndjeshme nga pikëpamja kulturore. Ajo gjithashtu do të inkurajojë kureshtjen kulturore dhe kapacitetin për kërkim të dhënash kulturore të nevojshme për detyrat e përkthimit.

- **Punë Praktike**

Ky modul ka për qëllim t'u japë studentëve të programit të magjistraturës përkthim/Interpretim që kanë pak apo nuk kanë aspak përvojë paraprake të punës së përkthimit të punojnë në një mjedis profesional të përkthimit/interpretimit në mënyrë të mbështetur që studentët të munden të shqyrtojnë përparimin e tyre profesional duke reflektuar mbi të, dhe në mënyrë kritike duke i dokumentuar përvojat e tyre. Lënda do ta lehtësojë vendosjen e studentëve me një ofrues shërbimi të vërtetë qoftë ai me kompani private, institucione qeveritare apo konferenca ndërkombëtare për ata që të fitojnë përvojë të dorës së parë të operacioneve dhe praktikave të përkthimit. Studentët në këtë mënyrë do të fitojnë aftësitë, teknikat dhe metodologjitë e punës që nevojiten për punë si përkthyes apo interpretues. Për çdo student individual, përmbajtja e lëndës do të ndryshojë në varësi të llojit të mjedisit të punës në të cilin ata e bëjnë pjesën praktike. Megjithatë, pritet se të gjithë studentët do të ndeshen me sfida të ngjashme të një natyre praktike, duke përfshirë: punë me afate, punë në ekipe, renditje sipas rëndësisë dhe menaxhim i kohës, IT aftësi, aftësi organizative. Studentëve do t'u kërkohet të mbajnë një regjistrim të përditshëm të pjesës praktike të tyre (në ditar pune ose libër regjistrimi) që të munden të japin mendim kritik për aktivitetet e tyre të vazhdueshme. Përveç kësaj, ata duhet të shkruajnë një kumtesë vetëreflektuese që lidh disa prej koncepteve teorike që ata i kanë hasur në lëndët e tyre në vendin aktual të punës.

- **Globalizimi dhe Mediumet e Reja**

Lënda do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët do të përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit të cilat njëherësh shënuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilinalizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari i përkufizon situatat e caktuara tipike të të

folurit.

- **Multilingualizmi dhe Multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termet: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Komunikimi Profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Menaxhimi i Projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: - Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; - Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; - Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; - Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; - Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; - Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e Optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikën e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet Etike dhe e Drejta në Teknologjitë e Informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: - Të zhvillojë kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; - Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; - Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; - Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; - Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të Drejtave të Njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.

- **Aplikacionet e TI për Përpilimin e një Punimi Shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: - T'u tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. - Zbatimi praktik i këtyre



objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.